



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 4215 Prot

Lezhë, më 07/09/2025

URDHËR

Nr. 187, datë 07/09/2025

PËR
NGRITJEN E KOMISIONIT TË MBROJTJES CIVILE

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 29 të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; pikës 2 dhe 5 të nenit 9; nenit 11; pikave 2 dhe 6 të nenit 14; pikës "b" të nenit 27; pikave 2 dhe 3 të nenit 29; nenit 30; pikës 2 të nenit 63, të ligjit nr.45/2019, datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile"; pika 15 e VKM Nr.923 datë 25.11.2020 "Për funksionimin e organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të Mbrojtjes Civile.

URDHËROJ

1. Ngritjen e Komisionit të Mbrojtjes Civile në Bashkinë Lezhë me përbërjen si më poshtë:

Nr.	Emri, mbiemri	Pozicioni i punës	Funksioni
1	Pjerin Ndreu	Kryetar i Bashkisë	Kryetar i Komisionit
2	Eueda Molla	Nënkryetare e Bashkisë	N/kryetar i Komisionit
3	Oltion Gjoni	Shef i Komisarariatit të Policisë Vendore Lezhe	Anëtar
4	Gjergj Prendi	Drejtor i Emergjencave Civile (drejtor).	Anëtar
5	Flamur Kuqi	Drejtor i Planifikimit të Territorit (drejtor).	Anëtar
6	Paulin Gjergji	Drejtorja e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve (drejtor).	Anëtar
7	Eraldo Smaçi	Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit (Kryeinspektor)	Anëtar
8	Leonard Palaj	Policia Bashkiake (Kryeinspektor)	Anëtar
9	Marte Fetaj	Drejtorja e Shërbimit Social (drejtor).	Anëtar

10	Keler Sufja	Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve	Anëtar
11	Renaldo Xhanej	Drejtoria e Turizmit dhe Kulturës, (drejtor).	Anëtar
12	Mariolina Lleshi	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit (Drejtor)	Anëtar
13	Denis Pervathi	Drejtoria e të Ardhurave Vendore	Anëtar
14	Altin Lleshi	Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve Publike (Drejtor)	Anëtar
15	Elton Zefi	Drejtoria e Shërbimeve Publike, (drejtor)	Anëtar
16	Ferdinand Preçi	Drejtoria për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin (MZSH) (drejtor)	Anëtar
17	Vasilika Laska	Drejtoria e Projekteve Strategjike, Evropes, Migracionit, Diaspores, Komunikimit dhe Transparences., (drejtor)	Anëtar
18	Jetmira Leka	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	Anëtar
19	Zef Maçi	Sh.A. Ujësjellës Kanalizime, Lezhë, (drejtor)	Anëtar
20	Nikolin Prendi	Drejtoria Rajonale e Ujitjes e Kullimit	Anëtar
21	Brahim Demi	Administrator i Njësisë Administrative Shëngjin	Anëtar
22	Redon Gjeloşi	Administrator i Njësisë Administrative Balldren	Anëtar
23	Pjeter Gjini	Administrator i Njësisë Administrative Blinisht	Anëtar
24	Gjeke Makaj	Administrator i Njësisë Administrative Shënkoll	Anëtar
25	Leonard Perjaku	Administrator i Njësisë Administrative Zejmen	Anëtar
26	Xhoana Kodra	Administrator i Njësisë Administrative Kolsh	Anëtar
27	Eraldo Marku	Administrator i Njësisë Administrative Kallmet	Anëtar
28	Gent Marku	Administrator i Njësisë Administrative Dajç	Anëtar
29	Agustin Zefi	Administrator i Njësisë Administrative Ungrej	Anëtar
30	Elson Frroku	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, (drejtor)	Anëtar

31	Andi Marku	Drejtor i OSHE-se Lezhë	Anëtar
32	Jolanda Gjeçi	Përfaqësuesi i Kryqit të Kuq Shqiptar, Dega Lezhë	Anëtar

2. Detyrat e Komisionit të Mbrojtjes Civile janë si më poshtë vijon:

- a) Të shërbejë si organ këshillues për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin në nivelin vendor nga Kuaçri Sendai për Reduktimin e Riskut të Fatkeqësive, Axfenda e Re Urbane, Axfenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Marrëveshja e Parisit për Ndryshimet Klimatike.
- b) Të shërbejë si organ këshillues për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, Plani i qarkut për emergjencat si edhe Plani vendor për emergjencat civile.
- c) Të shërbejë si organ këshillues për të siguruar që të gjitha politikat dhe dokumentet strategjike të bashkisë të jenë të informuara rreth riskut nga fatkeqësitë dhe të jenë të pajisura me masa për ta reduktuar atë, me qëllim garantimin e sigurisë së komunitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij.
- ç) Të shërbejë si organ këshillues për të siguruar që planifikimi dhe zhvillimi i territorit në nivel vendor të përgatiten në përputhje me dokumentet e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë dhe me strategjitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.
- d) Të planifikojë, organizojë, koordinojë dhe kontrollojë të gjithë masat për parandalimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë në territorin e bashkisë dhe të sigurojë bashkërendimin e të gjitha aktiviteteve të strukturave shtetërore dhe joshtetërore në bashki për këtë qëllim.
- dh) Në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe degët territoriale, Prefektin e qarkut, organizatat e ndryshme ndërkombëtare, subjektet private, shoqatat dhe organizatat e shoqërisë civile si dhe ekspertët privatë, të kryejë.
 - Të bëjë vlerësimin e risqeve nga fatkeqësitë në territorin e bashkisë Lezhë, ta rishikojë atë jo më pak se një herë në çdo tre vjet dhe dokumentin e hartuar ta dërgojë për miratim në Këshillin Bashkiak.
 - strategjinë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe ta rishikojë atë jo më pak se një herë në çdo pesë vjet dhe dokumentin e hartuar ta dërgojë për miratim në Këshillin Bashkiak.
 - planin vendor për emergjencat civile dhe ta rishikojë atë jo më pak se një herë në çdo tre vjet dhe dokumentin e hartuar ta dërgojë për miratim në Këshillin Bashkiak.
- e) Të bashkëpunojë me Komisionin e Mbrojtjes Civile në nivel Qarku dhe komisionet përkatëse të bashkive fqinje, për kryerjen e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë në territorin e bashkisë si edhe vlerësimin e nevojave.
- ë) Të vëzhgojë në mënyrë të vazhdueshme funksionimin e sistemit të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në territorin e bashkisë

- dhe të punojë për të informuar në kohë në lidhje me risqet dhe fatkeqësitë, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Prefektin e Qarkut dhe komunitetet e rrezikuara.
- f) Të bashkërendojë veprimtaritë për organizimin dhe pajisjen e forcave të ndërhyrjes në rastet e emergjencave.
 - g) Të ndjekë e zbatojë kryerjen e investimeve parandaluese, mbrojtese e rehabilituese nga fatkeqësitë, dhe informon për këto investime Prefektin e Qarkut Lezhë dhe AKMC.
 - h) Të ndjekë e kontrollojë mbajtjen në gatishmëri të sistemit të mbrojtjes nga zjarri, kalueshmërinë e rrugeve rurale, vendet e strehimit, mbledhjen e administrimin e rezervave ushqimore për njerëzit dhe gjënë e gjallë.
 - i) Të ndjekë e kontrollojë mbajtjen në gatishmëri të infrastruktures së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja dhe digat e rezervuareve në administrim të bashkisë, si dhe të lumenjve, hidrovoreve, kanaleve të para në administrim të Drejtorisë Rajonale të Ujitjes e Kullimit.
 - j) Mbështet dhe ndihmon drejtuesin e operacionit për menaxhimin e situatave emergjente nga fatkeqësia natyrore.
 - k) Të ndjekë dhe të zbatojë të gjitha detyrat e tjera në rastet e emergjencave, si në rastet e shpalljes dhe ato të mosshpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore.
 - gj) Sekretari i komisionit përgatit të gjitha materialet e mbledhjeve të radhës së komisionit, mban procesverbalet e takimeve dhe i ndan ato me anëtarët e komisionit.
3. Funksionimi i Komisionit të Mbrojtjes Civile përcaktohet në rregulloren "Per funksionimin e brendshem të komisionit të Mbrojtjes të miratuar në kete komision.
4. Urdhri i Kryetarit të Bashkisë Lezhë me nr.536, datë 07.10.2024 "Për ngritjen e Komisionit të Mbrojtjes Civile në Bashkinë Lezhë" shfuqizohet.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
PJERIN NDREU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

**RREGULLORE
PËR FUNKSIONIMIN E BRENDSHËM TË KOMISIONIT TË MBROJTJES
CIVILE**

Në mbështetje të pikës 2 dhe 3 të nenit 29 dhe nenit 30, të ligjit nr.45/2019, datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen civile", Komisioni i Mbrojtjes Civile, vendosi të aprovojë rregulloren për funksionimin e brendshëm të tij si më poshtë vijon:

- a. Komisioni i Mbrojtjes Civile (KMC) funksionon sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile" si edhe bazuar Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Lezhë Nr. __, datë __. __.2025 ku saktësohen përgjegjësitë dhe detyrat e këtij komisioni.
- b. Rregullorja ka si qëllim funksionimin e brendshëm të KMC-së, të sekretarisë teknike, si edhe të marrëdhënieve ndërmjet anëtarëve të Komisionit.
- c. KMC funksionon në mënyrë të vazhdueshme, si në situata normale ashtu edhe në situata emergjente.
- d. KMC mblidhet me kërkesën e Kryetarit të tij, i cili përcakton rendin e ditës së mbledhjes dhe drejton mbledhjen. Mbledhja mund të zhvillohet edhe/ose me kërkesë të 30 % të anëtarëve të tij. Me miratimin e Kryetarit, çdo anëtar ka të drejtë të propozojë edhe çështje të tjera, të cilat nuk janë të përfshira në rendin e ditës.
- e. KMC e ushtron veprimtarinë e tij nëpërmjet mbledhjeve të zakonshme, të cilat janë të vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se 50 %+1 e anëtarëve, dhe janë të hapura. Në rastet kur pjesëmarrja nuk sigurohet, mbledhja e Komisionit do të zhvillohet jo më vonë se dy javë nga data e njoftimit të ri. Në rastet e situatave emergjente mbledhja zhvillohet menjëherë pavarësisht nga numri i pjesëmarrësve.
- f. KMC mblidhet jo më pak se një herë në tre muaj në situata normale, ose rast pas rasti sipas nevojës, si dhe qëndron i mbledhur në situata të emergjencave civile.
- g. Njoftimi për mbledhjen bëhet të paktën 10 (dhjetë) ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes në situata normale ndërsa njoftimi bëhet për mbledhje të paparashikuar apo urgjente në situata gatishmërie apo të emergjencës së ndodhur.
- h. Në rastet kur mbledhja është e domosdoshme të zhvillohet ditën e caktuar dhe kryetari e ka të pamundur drejtimin e mbledhjes, ai cakton Nënkryetarin ose një nga anëtarët e Komisionit, për kryesimin e mbledhjes si kryetar provizor.
- i. KMC vendos me shumicë votash ndërsa në rastet kur numri i votave është ndarë në mënyrë të barabartë, vendos vota e Kryetarit të Komisionit.
- j. Sipas nevojës, mund të krijohen grupe tematike me anëtarë nga: prefekti i qarkut, institucionet qendrore dhe degët e tyre rajonale, organizatat e ndryshme

ndërkombëtare, përfaqësues të Klerit, subjektet private, shoqatat dhe organizatat e shoqërisë civile, studiues, shkencëtarë si dhe ekspertët privatë, sipas shtojcës 1 të kësaj rregulloreje. Këta anëtarë ftohen në raste specifike, ose edhe në mbledhjet e radhës, varësisht çështjeve dhe problematikave të trajtuara.

k. Drejtoria e Emergjencave Civile në bashki luan rolin e Sekretarisë Teknike të Komisionit të Mbrojtjes Civile

l. Sekretaria Teknike e Komisionit të Mbrojtjes civile merr të gjitha masat për organizimin e mbledhjeve të programuara, kryen njoftimin, përgatit dhe shpërndan materialet përkatëse të mbledhjes në kohë, për secilin anëtar.

m. Në mbledhjet e Komisionit të Mbrojtjes civile mbahet procesverbali/minutat e takimit, nga sekretari i sekretarisë teknike, ku shënohen data, vendi i mbledhjes, anëtarët e pranishëm, çështjet që u diskutuan, diskutimet e pjesëmarrësve dhe rezultatet e arritura. Procesverbali u shpërndahet me email anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes Civile, jo më vonë se një javë pas përfundimit të mbledhjes. Ai nënshkruhet nga sekretari i sekretarisë teknike të Komisionit të Mbrojtjes Civile.

n. Komisioni i Mbrojtjes Civile, nëpërmjet sekretarisë, kontrollon dhe verifikon zbatimin e vendimeve apo dhe të detyrave të marra/caktuara në mbledhjet e tij si nga anëtarët e komisionit, të institucioneve të tjera shtetërore e kërkimore-shkencore, nga subjektet fizike e juridike, private e publike, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike, shoqërore, kulturore e argëtuese, në territoret e Bashkisë së Lezhës.

o. Drejtoria e Emergjencave Civile dhe çdo anëtar i Komisionit të Mbrojtjes Civile informojnë rregullisht për zbatimin e vendimeve e të detyrave në mbledhjen e ardhshme të Komisionit të Mbrojtjes Civile.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
PJERIN NDREU

